22447

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**
**Nr.** 22447

**VENDIM**
**PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK**

Ne Tirane,me daten 15.12.00 (                ) une Shule Capo gjyqtar i Gjykates se Rrethit Tirane,mbasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi per regjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar"A-2000" si person JURIDIK

**KONSTATOVA**

Kerkesa e kerkuesit KRENAR AGUSHI,per regjistrimin si person juridik i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar"A-2000" me :
**Kapital :** Vendas
**Kohezgjatje :** Mbi 10 vjet
**Seli :** Tirane, Rr. Hamit Shijaku ,Lagjja 4, Nr. 3 Dhe perspektive shtrirjeje ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
**Objekt :** Sherbimi i Rojeve Civile te Armatosura,per ruajtjen e objekteve te ndryshme sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj Shoqerie dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve te tyre dhe shoqerimin e vlerave monetare,duke mos perjashtuar mundesine e ruajtjes dhe te personave fizike,sipas kerkesave te paraqitura prej tyre dhe gjithmone sipas kontrates qe do te lidhet per kete qellim midis ketyre personave dhe shoqerise ne fjale per Sherbimin e Rojeve Civile te Armatosura.
**Kapital Themeltar :** 100.000 (njeqind mije) leke.
Krenar Agushi - ortak i vetem,Administrator i vetem i shoqerise,disponon nje shume prej 100.000 (njeqind mije) lekesh baraz me 100 %.
eshte ne perputhje me ligjin dhe si e tille duhet pranuar.

**Per keto arsye :**

Ne baze te ligjes 7696 dt. 07.04.1993 " Per Sherbimin e Rojeve Civile te Armatosura" dhe Vendimit te K.M. Nr.210 dt 10.05.1993, Ne baze te ligjit 7638 dt.19.11.1992.

**VENDOSA**

*Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar* "A-2000" *me :*
**Kapital :** Vendas
**Kohezgjatje :** Mbi 10 vjet
**Seli :** Tirane, Rr. Hamit Shijaku,L.4, Nr. 3 Dhe perspektive shtrirje ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
**Objekt :** Sherbimi i Rojeve Civile te Armatosura,per ruajtjen e objekteve te ndryshme sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj Shoqerie dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve te tyre si dhe shoqerimin e vlerave monetare,duke mos perjashtuar mundesine e ruajtjes edhe te personave fizike,sipas kerkesave te paraqitura prej tyre dhe gjithmone sipas kontrates qe do te lidhet per kete qellim midis ketyre personave dhe shoqerise ne fjale per Sherbimin e Rojeve Civile te Armatosura.
Kapital Themeltar 100000 (njeqind mije) leke,i vendosur ne masen 100% nga Krenar Agushi,ortak i vetem themelues dhe Administrator i vetem i Shoqerise.

**Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.**

**GJYQTAR**
Shule Capo

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**
**Nr.** 22447/1 **i Vendimit**

# VENDIM
# I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me **dt. 23.07.2001,** une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, **Anila Capo**, pasi shqyrtova kerkesen e administratorit **Krenar Agushi** per depozitimin ne Zyren e rregjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "A – 2000" sh.p.k

## KONSTATOVA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " **A – 2000** " sh.p.k Tirane, eshte miratuar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane me **nr.22447 dt.15.12.1999** me ortak te vetem **z.Krenar Agushi.**

Ne baze te vendimit te **nr.1 dt.20.07.2001** ortaku i vetem i shoqerise **"A – 2000"** sh.p.k ka vendosur:

1. Pakesim i objektit te veprimtarise se shoqerise dhe lenien si objekt te saj vetem:
   - Sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perodrim te personave fizike ose juridike qe ushtrojne veprimtarine ne territorin e Republikes se Shqiperise.
   - Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizike shtetas shqiptare ose te huaj .

2. Bazuar ne ligjin nr.8770 date 19.04.2001 "Per sherbimet e ruajtjes dhe sigurise fizike"
   - Shtimi i kapitalit fillestar te kesaj shoqerie nga 100.000 ne 4.000.000 leke.
   - Emerimi i drejtuesit teknik te shoqerise z.Shkelqim Lazaj.

Te pasqyroje keto ndryshime ne rregjistrin tregtar. Me kerkesen e paraqitur kerkuesi kerkon depozitimin ne Zyren e rregjistrit tregtar te vendimit nr.1 date 20.07.2001 te ortakut te vetem.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa e tij eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te nenit 24 dhe dispozitave te tjera te ligjit Nr.7667, 7638 e 7632,

**VENDOSA**

1. Pranimin e kerkeses.
   - Ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve publike e private.
   - Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizike shtetas shqiptar ose te huaj.
   - Shtimin e kapitalit fillestar te kesaj shoqerie nga 100.000 ne 4.000.000 leke.
   - Emerimin e drejtuesit teknik te shoqerise z.Shkelqim Lazaj.

2. Depozitimin ne zyren e rregjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"A-2000"sh.p.k** qe eshte vendimi nr.1date.20.07.2001.

3. Urdherimin e Zyres se rregjistrit tregtar te Gjykates Tirane te beje ndryshimet ne kolonen perkatese ne rregjistrin tregtar.

4. Te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**GJYQTARE**
**Anila CAPO**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË**
**Nr. 22447/2 i Vendimit**

# VENDIM
## I GJYQTARIT TË VETËM

Sot në **datën 11.03.2005**, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, **Ariana Caco**, pasi shqyrtova kërkesën e administratorit **Krenar Agushi** për depozitimin në Zyren e Regjistrit Tregtar të dokumentave të paraqitura në emër të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "A – 2000" sh.p.k

## KONSTATOVA

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " **A – 2000** " sh.p.k. është miratuar si person juridik me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me **nr.22447 datë 15.12.1999** me ortak të vetëm **z. Krenar Agushi.**

Në bazë të Vendimit **nr. 2, datë 07.03.2005** ortaku i vetëm i shoqërisë **"A – 2000"** sh.p.k. ka vendosur:

1. Bazuar në ligjin nr. 8770 datë 19.04.2001 "Për shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë fizike",
    - Shtimin e kapitalit fillestar të kësaj shoqërie nga 4.000.000 leke në 13.570.400 lekë.
    - Emërimin si drejtues teknik të shoqërisë z. Bardhosh Bershanaj.

Me kërkesën e paraqitur, kërkuesi kërkon depozitimin në Zyrën e Regjistrit Tregtar të Vendimit nr.2 datë 07.03.2005 të ortakut të vetëm.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kërkesa e tij është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

## PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 24 dhe dispozitave të tjera të ligjit Nr.7667, 7638 e 7632,

VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës.
   - Shtimin e kapitalit fillestar të kësaj shoqërie nga 4.000.000 lekë në **13.570.400 lekë.**
   - Emerimin si drejtues teknik të shoqërisë **z. Bardhosh Breshanaj.**

2. Depozitimin në Zyrën e Regjistrit Tregtar të dokumentave të paraqitura në emër të Shoqerisë me përgjegjësi të kufizuar **"A-2000" sh.p.k** që është vendimi nr. 2, datë 07.03.2005.

3. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar të Gjykates së Shkallës së Parë Tiranë të bëjë ndryshimet në kolonën përkatëse në regjistrin tregtar.

4. Të ndahen regjistrimet nga njëri - tjetri me vijë të kuqe.

**GJYQTARE**

**ARIANA CACO**

Vendimi i regjistrimit

22.447

- Emërtimi A-2000. SH.P.K.

- Kapitali 100.000 lekë

- Kohëzgjatja mbi 10 vjet

- Me objekt: tregti e personave fizikë juridikë (rroba etj.

- Me ortak dhe administrator të vetëm Florian Dajani

- Me seli në Hamit Shijaku nr 3 Tiranë

Statuti 3 fletë

Akt themelimi 2 fletë

data e vendimit 10.12.99

data e regjistrimit 15.12.99

[signature]

# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Ne Tirane me daten 10/12/ 1999 (nentedhjete e nente),une i nenshkruari Frenar Apushi i biri i Vizhdanit lindur ne 10/8/68 Erseke,banues ne Tirane,me adrese: Rr.Hamit Shijaku,L.4,Nr.3 me cilesine e ortakut te vetem,me vullnetin tim te lire e te plote,vendosa te krijoj Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin: "A-2000" me qender ne Tirane.

## HYRJE

### Neni 1

Ne kuptim te ketij akti,themelues eshte Frenar Apushi,ortaku i vetem themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "A-2000".

### Neni 2

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ~~me~~ "A-2000" me seli ne Tirane,dhe perspektive shtrirjeje ne te gjithe territorin e R.Shqiperise.

### Neni 3

Shoqeria "A-2000" eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas Statutit,ligjit 7696 date 7.04.1993 "Per sherbimin e rojeve civile te armatosura" dhe Vendimit te K.M Nr.210 date 10.05.1993 si dhe akteve te tjera te Legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## Objekti

### Neni 4

Objekti i Shoqerise "A-2000" do te jete:

*Sherbimi i Rojeve Civile te Armatosura,* per ruajtjen e objekteve te ndryshme sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj Shoqerie dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve te tyre dhe transportimin e vlerave monetare;duke mos perjashtuar mundesine e ruajtjes dhe te personave fizike,sipas kerkesave te paraqitura prej tyre dhe gjithmone sipas kontrates qe do te lidhet per kete qellim midis ketyre personave dhe Shoqerise ne fjale per *Sherbimin e Rojeve Civile te Armatosura.*

### Neni 5

Shoqeria "A-2000" do te filloje aktivitetin e saj nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane,si dhe pajisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve te Rajonit perkates.

### Neni 6

Shoqeria "A-2000" do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe **mbi 10 vjet**.

## KAPITALI I SHOQERISE

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise private "A-2000",arrin vleften 100000 (njeqind mije) leke.Ortaku i vetem Frenar Apushi e disponon kete shume,baras me 100%,e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prej tij.

## Bilanci,veprimtaria ekonomike,detyrimet

### Neni 8

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore,sigurimet shoqerore ,etj.

**Neni 9**

Ortaku i vetem themelues ose persona te tjere te autorizuar prej tij,kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve ekonomike,te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

**Juridiksioni**

**Neni 10**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "A-2000",e ka qendren e saj ne Tirane me adrese: Rr.Hamit Shijaku,L.4,Nr.3.

**Neni 11**

Shoqeria "A-2000", mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e R.Shqiperise.

**Neni 12**

Te gjitha mosmarreveshjet me persona juridike e fizike,vendas ose te huaj,si dhe me organet shteterore,zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

**THEMELUES**

Krenar Agushi

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA - TIRANE**
**NR** 8064 **REP**
**NR** 738 **KOL**

**VERTETIM**

Sot me daten 10/12/99 ,ne Tirane,ne zyren e Noterise Tirane, u paraqit personalisht KRENAR AGUSHI para meje Noteres, ILIR QEIMANI ,per identitetin e te cilit u informova nga dokumenti i identitetit qe ai mbante,madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai deklaroi se **Akti i Themelimit** i mesiperm,i redaktuar jashte kesaj zyre,eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi ate rregullisht.Une Noterja e gjej kete veprim ne perputhje me Ligjen,e firmos rregullisht sipas Ligjes.

NOTER

Ilir Qeimani

Qeimani

POSTE TAKSE 10 LEKE SHQIPERISE

# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# " A – 2000 "sh.p.k

Ne Tirane me dt.20/07/2001, une I nenshkruari Krenar Agushi, I biri I Vizhdanit, lindur ne 10.08.1968 ne Tirane, banues ne Tirane, me adrese:Rr."Hamit Shijaku, L.4, Nr.3, me date 15.12.1999, me cilesine e ortakut te vetem, me vullnetin tim te lire e te plote krijova shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te amertuar **"A – 2000"** sh.p.k. Ne baze te Ligjit nr.8770 date 19.04.2001 vendosa te bej ndryshimet ne rregjistrin tregtar duke depozituar aktin e themelimit te ri

**HYRJE**

**Neni 1**

Ne kuptim te ketij akti, themelues eshte **Krenar Agushi**, ortak I vetem themelues I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "A-2000"sh.p.k.

**Neni 2**

Qellimi I ketij akti themelues eshte krijimi I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "A-2000"sh.p.k, me seli ne Tirane, dhe me perspektive te hape dege dhe filjale ne te gjithe territorin e R.Shqiperise dhe jashte saj.

**Neni 3**

Shoqeria "A-2000"sh.p.k eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas Statutit, Ligjit 8770 dt.19.04.2001 "Per sherbimin e ruajtjes dhe Sigurise Fizike", udhezimeve te M.R.P si dhe akteve te tjera te Legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 4**

Shoqeria "A-2000"sh.p.k ne veprimtarine e saj do te kete drejtues teknik I cili duhet te plotesoje te gjitha kushtet e parashikuara ne ligjin 8770 dt.19.04.2001 dhe Udhezimin e M.R.P nr.1487 dt.21.06.2001 "Per procedurat e dhenies dhe heqjes se licencave dhe lejeve per shoqerite e ruajtjes dhe sigurise fizike".
Drejtuesi teknik eshte drejtuesi me I larte teknik I shoqerise dhe pergjegjesi ligjor per drejtimin, bashkerendimin dhe kontrollin e sherbimit te ruajtjes dhe te sigurise fizike.Drejtues teknik emerohet z.Shkelqim Lazaj.

**OBJEKTI**

**Neni 5**

Objekti I shoqerise "A-2000"sh.p.k do te jete:

- Ruajtja dhe sigurimi fizik i objekteve publike e private.
- Sigurimi fizik, mbrojtja e jetes dhe shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj.

**Neni 6**

Shoqeria "A- 2000"sh.p.kdo te filloje aktivitetin e saj nga dita e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane, si dhe pajisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve te Rajonit perkates.

**Neni 7**

Shoqeria "A-2000"sh.p.k do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe mbi 10 vjet.

## KAPITALI I SHOQERISE

**Neni 8**

Kapitali themeltar I shoqerise "A-2000"sh.p.k arrin vleften 5.000.000(pese milion) leke.Ortaku I vetem Krenar Agushi e disponon kete shume, baras me 100%, e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prej tij.

## BILANCI, VEPRIMTARIA EKONOMIKE,DETYRIMET

**Neni 9**

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore, sigurimet shoqerore etj.

**Neni 10**

Ortaku I vetem themelues ose persona te tjere te autorizuar prej tij, kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

## JURIDIKSIONI

**Neni 11**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "A-2000"sh.p.k, e ka qendren e saj ne Tirane me adrese Rr."Hamit Shijaku" L.4.Nr.3.

**Neni 12**

Shoqeria "A-2000"sh.p.k, mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e R.Shqiperise.

**Neni 13**

Te gjitha mosmarreveshjet me persona juridike e fizike, vendas ose te huaj, si dhe me organet shteterore , zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

**Neni 14**

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj.Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

**THEMELUES**

**KRENAR AGUSHI**

1

AKT KONSTITUIV
STATUTI
I
SHOQERISE PER SHERBIMIN E ROJEVE CIVILE "A-2000" SH.P.K.

Sot me daten 10/12/1999 ,dite e premte ,para meje NOTERIT u paraqit personalisht zoti Krenar Apushi , lindur me 10/8/1968 ,banues ne Tirane, Rr:"Hamit Shijaku" L.4. Nr. 3 ,i cili ka vendosur te krijoje shoqerine private per sherbimin e rojeve civile ne mbeshtetje te ligjit Nr.7696 date 07/04/1993 "Per sherbimin e rojeve civile" dhe vendimit te K.M. Nr.210 date 10/05/1993.Aktiviteti i shoqerise do te zhvilohet duke u mbeshtetur ne dispozitat e ketij statuti,qe do te perbeje edhe aktin baze te rregullimit,struktures,organizimit.

Kreu i I.Emertimi,selia,objekti,jetegjatesia.

Neni 1

Krijohet shoqeria private per sherbimin e rojeve civile ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e qe shkurt do te quhet shoqeria "A-2000" SH.P.K.

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Rr:"Hamit Shijaku" L.4.Nr. 3 Tirane ,por nuk perjashtohet mundesia e transferimit te selise apo dhe krijimit te degeve,agjensive e perfaqesive.Edhe pse selia ndodhet ne Tirane,aktiviteti i shoqerise sipas nevojave qe do te paraqiten per permbushjen e qellimeve te saj,do te kryhet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.(__________).

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete sherbimi i rojeve civile per ruajtjen e objekteve te ndryshme sipas kontrates qe do te lidhet midis kesaj shoqerie dhe personit juridik apo fizik qe i perkasin objektet,duke mos perjashtuar mundesine e ruajtjes dhe te personave te ndryshem sipas kerkesave te paraqitura prej tyre dhe gjithmone sipas kontrates qe do te lidhet per kete qellim midis ketyre personave apo te treteve qe e kerkojne kete dhe shoqerise ne fjale per sherbimin e rojeve civile.

Objekti i veprimtarise se shoqerise realizohet nen emrin e shoqerise nga personat e zgjedhur nga administratori i vetem i shoqerise dhe te paisur me miratimin perkates nga organet e rendit publik.

Neni 4

Jetegjatesia e shoqerise do te jete 5 vjet,me te drejte rinovimi te afatit.Nuk perjashtohet mundesia qe per arsye te perligjura dhe te justifikuara shoqeria t'a pushoje aktivitetin e saj edhe para afatit 5- vjecar,duke njoftuar per kete qellim organet e rendit publik qe kane leshuar licencen-lejen per aktivitetin e mesiperm.

Neni 5

Vendodhja ligjore e personave te kontraktuar nga shoqeria dhe te paisur me lejen perkatese nga organet e rendit ne raport me shoqerine eshte ajo qe rezulton nga libri (lista) e anetareve e miratuar nga organet e rendit publik te rrethit e ato qendrore.

Neni 6

Kapitali i shoqerise i investuar totalisht nga administratori i vetem zoti Frenar Apushi i cili do te sherbeje per perfitimin e aktivitetit te shoqerise eshte 100000 (njeqindmije) leke,i cili do te sherbeje per kryerjen e sherbimeve te para te karakterit administrativ,financiar e pagesen e personelit.

Neni 7

Me miratimin e administratorit te vetem nuk perjashtohet mundesia qe te hyje ortak ne shoqeri duke ju dhene (transferuar) kuota sipas marreveshjes se arritur midis tij dhe administratorit te shoqerise.

Kreu i III. Ortaku i vetem.

Neni 8

Shoqeria "A-2000" SH.P.K drejtohet nga ortaku i vetem i saj zoti Frenar Apushi .Eshte ai si administratori i vetem i shoqerise qe vendos per gjithcka qe lidhet me aktivitetin,organizimin,ndarjen e punes,caktimin e detyrave te pergjithshme e te posacme,kontrollin per zbatimin e tyre dhe marrjen e masave perkatese per mospermbushjen e rregullt nga cilido punonjes.

Ortaku i vetem mund te delegoje kompetencat e tij personave te tjere,gjithmone me shkrim.Per problemet e ndryshme qe merren vendim prej tij ne vendin e asamblese,ato evidencohen ne cdo regjister te vecante.

Eshte ortaku i vetem qe ka te drejten me vendimet e tij te beje ndryshime ne statutin e shoqerise,duke pasur per kete qellim detyrimin per ti evidencuar ato ne regjistrin perkates ne gjykate,organin e rendit publik qe ka dhene miratimin.

Neni 9

Eshte ortaku i vetem qe ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise me te trete dhe qe perfundon lidhjen e kontratave me organet e rendit publik;kontratat e punes me personelin dhe sherbimet qe do te kryejne;dhe kontrata me te trete qe jane persona fizike apo juridike dhe kerkojne sherbimin e shoqerise "A-2000" SH.P.K.

Kreu i IV. Administrimi

Neni 10

Administrimi i shoqerise "A-2000" SH.P.K i perket ortakut te vetem i cili eshte njekohesisht edhe administrator.Me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise nuk perjashtohet mundesia qe detyren e administrimit (administratorit) t'a kryeje edhe person tjeter, kundrejt te drejtave qe do ti besohen nga ortaku i vetem administrator i shoqerise.

Neni 11

Punesimi i personave ne shoqeri qe duan dhe pranojne te kryejne aktivitetin e sherbimit te rojes behet kundrejt kontrates se lidhur midis secilit dhe administratorit te vetem te shoqerise.

Po keshtu me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise mund te pajtohen ne pune edhe persona te tjere,detyra e te cileve do te jete ne ndihme dhe funksion te sherbimit te rojes si dhe aktivitetit per pergatitjen dhe kualifikimin teoriko-praktik te rojeve ne perputhje me teknikat bashkekohore,si dhe duke u mbeshtetur ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Kreu V. Bilanci dhe fitimet

Neni 12

Veprimet kontabel te shoqerise mbyllen me 31 Janar te cdo viti.Ortaku i vetem ben aprovimin e bilancit brenda 4 muajve nga mbyllja e veprimeve dhe jo me vone se 6 muaj.

Neni 13

Fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise nxirren pasi zbriten te gjitha shpenzimet e bera,rrogat e personelit te rojes,atij administrativ dhe pasi paguhen te gjitha taksat e

tatimet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.Nje perqindje e fitimit sipas vendimit te ortakut te vetem destinohet per persosjen e sherbimit te rojes me aparate e mjete te tjera moderne dhe per permiresimin ne pergjithesi te aktivitetit te shoqerise,dhe pjesa tjeter i perket ortakut qe ka bere financimin per krijimin e shoqerise.

Neni 14

Pagimi i personelit do te behet me termin qe do te fiksohet ne kontraten e lidhur me ta.

Kreu i VI. Shkrirja dhe likujdimi

Neni 15

Duke parashikuar per cdo moment dhe per cdo shkak shkrirjen e shoqerise,ortaku i vetem cakton edhe nje likujdator i cili duke iu nenshtruar normave te padiskutueshme te ligjit kryen likujdimet e te treteve.

Ne rastin e shkrirjes se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar - "A-2000" deri ne likujdimin e plote te veprimtarise se saj ajo duhet te vazhdoje aktivitetin,duke njoftuar per kete qellim edhe te tretet qe kane kerkuar e jane siguruar me sherbimin e rojes civile nga shoqeria "A-2000" SH.P.K per te marre masat edhe keta te fundit per sigurimin dhe ruajtjen e objeklteve te kerkuara e te kontraktuara per kete.

Kreu VII. Dispozitat e pergjithshme

Neni 16

Shoqeria "A-2000" SH.P.K e fillon aktivitetin e saj pasi te jete regjistruar si person juridik ne gjykaten e rrethit Tirane,pasi te kete marre miratimin nga organet e rendit te rrethit e te jete pajisur me licencen,lejen perkatese sic eshte parashikuar edhe ne vendimin e K.M Nr.210 date 10/05/1993.

Neni 17

Shoqeria "A-2000" e ushtron aktivitetin e saj e saj ne perputhje me dispozitat e ketij statuti,ligjit Nr.7696 date 07/04/1993 dhe vendimit te K.M te siperpermendur si dhe ne kontratat qe jane lidhur per permbushjen e qellimeve te permendura ne Nenin 3 e 11 te ketij statuti.Ajo e bazon aktivitetin e saj ne te gjitha aktet ligjore e nenligjore qe lidhen me te dhe qe jane aktualisht ne fuqi.

Neni 18

Ky akt krijimi dhe statut hartohet ne tre kopje origjinale njera prej te cilave depozitohet ne gjykaten e rrethi Tirane,njera organit te rendit qe jep miratimin si dhe e treta mbahet nga administratori i vetem dhe i bashkelidhet dokumentacionit baze te shoqerise.

Tirane,me 10/12/1999

ADMINISTRATORI I VETEM

Kreuar Ajusli

# AKT KONSTITUIV
# STATUTI
# SHOQERISE PER RUAJTJEN DHE SIGURISE FIZIKE
# " A – 2000 "sh.p.k

Sot me daten 20/07/2001, para meje noterit u paraqit personalisht z.Krenar Agushi, lindur me 10.08.1968, banues ne Tirane, Rr."Hamit Shijaku"L.4 Nr.3, I cili ka vendosur te bej disa ndryshime ne statutin e "A-2000"sh.p.k, ne baze te vendimit nr.1 dt.20.07.2001 te ortakut te vetem te shoqerise"A-2000"sh.p.k.

Aktiviteti I shoqerise do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne dispozitat e ketij statuti, qe do te perbeje edhe aktin baze te rregullimit, struktures, organizimit.

## KREU I . Emertimi , selia , objekti , jetegjatesia.

### Neni 1

Une Ortaku i Vetem **Krenar Agushi** 15.12.1999 kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "A-2000"sh.p.k dhe ne baze te ligjit nr.8770 date 19.04.2001 ndryshoj emertimin e kesaj shoqerie ne Shoqeri te Ruajtjes dhe Sigurise Fizike.

### Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Rr."Hamit Shijaku"L.4 nr.3 Tirane, por nuk perjashtohet mundesia e transferimit te selise apo dhe krijimit te degeve, angjensive e perfaqsive.Edhe selia ndodhet ne Tirane, aktiviteti I shoqerise sipas nevojave qe do te paraqiten per permbushjen e qellimeve te saj, do te kryhet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

### Neni 3

Shoqeria "A-2000"sh.p.k do te kete per object te veprimtarise se saj:

- Ruajtjen e sigurimin fizik te objekteve publike e private.
- Sigurimin fizik, mbrojtjen e jetes dhe shendetit te shtetasve vendas e te huaj.

### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe kohore mbi 10 vjet.

### Neni 5

Vendodhja ligjore e personave te kontraktuar nga shoqeria dhe te pajisur me lejen perkatese nga organet e rendit ne raport me shoqerine eshte ajo qe rezulton nga libri (lista) e anetareve e miratuar nga organet e rendit publik te rrethit e ato qendrore.

### Neni 6

Kapitali I shoqerise I investuar totalisht nga administratori I vetem z.Krenar Agushi Per fillimin e aktivitetit te shoqerise eshte 5.000.000(pese million) leke, I cili do te sherbeje

per kryerjen e sherbimeve te para te karakterit administrative, financiar e pagesen e personelit.

**Neni 7**

Me miratimin e administratorit te vetem nuk perjashtohet mundesia qe te hyje ortak ne shoqeri duke ju dhene (transferuar) kuota sipas mareveshjes se arritur midis tij dhe administratorit te shoqerise.

## KREU II . ORTAKU I VETEM

**Neni 8**

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Ortaku i Vetem duke u bazuar ne dispozitat ligjore te percaktuara ne ligjin "Per shoqerite tregtare", ne lidhje me marrjen e vendimeve. Ai vendos vete kryesisht per keto ceshtje:

- Miraton planin dhe programin e zhvillimit dhe aktat e pergjithshme te shoqerise.
- Merr vendime per ndryshimin e formes, emertimit, selise, kapitalit, veprimtarise se shoqerise, ndryshimin ne zoterimin e kuotave te kapitalit te shoqerise, pranim te ortakeve, pjesemarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera dhe anasjelltas.
- Miraton raportet financiare e bilancin vjetor, vendos per perdorimin e fitimit, organizimin e shoqerise dhe per prishjen e saj.
- Emeron dhe shkarkon administratorin, likujdatorin, ekspertet kontabel si dhe drejton veprimtarine e rendesishme te shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon Drejtuesin Teknik te shoqerise.

Marrja e vendimeve realizohet me inisiativen e Ortakut te Vetem ose me kerkese te administratorit a ekspertit kontabel, te cilet ne kete rast duhet t'i njoftojne ortakut projektin dhe relacionin shpjegues 15 dite perpara takimit.

**Neni 9**

Eshte ortaku I vetem qe ka te drejten e perfaqsimit te shoqerise me te trete dhe qe perfundon lidhjen e kontratave me organet e rendit publik , kontratat e punes me personelin dhe sherbimin e shoqerise "A-2000"sh.p.k.

## KREU III.ADMINISTRIMI

**Neni 10**

Shoqeria administratohet nga nje person fizik qe mund te jete vete Ortaku i Vetem ose nje person tjeter i emeruar ne kete detyre.
Administrator i pare i shoqerise emerohet **z.KRENAR AGUSHI**.
Administratori ka te gjitha kopetencat per te kryer veprimet e administrimit, ne ineteres te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet kopetencave te percaktuara ne kete statut.
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem.
Kohezgjatja e mandatit te administratorit eshte per 3(tre) vite financiare radhazi dhe mund te perseritet.
Mandati perfundon perpara ketij afati kur administratori nuk ploteson kushtet per te kryer kete detyre, jep doreheqjen prej saj ose shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem a nga nje vendim gjykate.
Drejtues Teknik i shoqerise emerohet z.Shkelqim Lazaj, me arsim te larte ushtarak policor.

**Neni 11**

Punesimi I personave ne shoqeri qe duan dhe pranojne te kryejne aktivitetin e sherbimit te rojes behet kundrejt kontrates se lidhur midis secilit dhe administratorit te vetem te shoqerise.

Po keshtu me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise mund te pajtohen ne pune edhe persona te tjere, detyra e te cileve do te jete ne ndihme dhe funksion te sherbimit te rojes si dhe aktivitetit per pergatitjen dhe kualifikimin teorik-praktik te rojeve ne perputhje me teknikat bashkekohore, si dhe duke u mbeshtetur ne dispozitat ligjore ne fuqi.

## KREU IV . BILANCI DHE FITIMET

**Neni 12**

Veprimet kontabel te shoqerise mbyllen me 31Janar te cdo viti.Ortaku I vetem ben aprovimin e bilancit Brenda 4 muajve nga mbullja e veprimeve dhe jo me vone se 6 muaj.

**Neni 13**

Fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise nxirren pasi zbriten te gjitha shpenzimet e bera, rrogat e personelit te rojes, atij administrative dhe pasi paguhen te gjitha taksat e tatimet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Nje perqindje e fitimit sipas vendimit te ortakut te vetem destinohet per persosjen e sherbimit te rojes me aparate e mjete te tjera moderne dhe per permiresimin ne pergjithesi te aktivitetit te shoqerise, dhe pjesa tjeter I perket ortakut qe ka bere financimin per krijimin e shoqerise.

**Neni 14**

Pagimi I personelit do te behet me termin qe do te fiksohet ne kontraten e lidhur me ta.

## KREU V . SHKRIRJA DHE LIKUJDIMI

**Neni 15**

Duke parashikuar per cdo moment dhe per cdo shkak shkrirjen e shoqerise, ortaku I vetem cakton edhe nje likujdator I cili duke iu nenshtruar normave te padiskutueshme te ligjit kryen likujdimet e te treteve.

Ne rastin e shkrirjes se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A-2000"sh.p.k deri ne likujdimin e plote te veprimtarise se saj duhet te veazhdoje aktivitetin, duke njoftuar per kete qellim edhe te tretet qe kane kerkuar e jane siguruar me sherbimin e Ruajtjes nga shoqeria "A-2000"sh.p.k per te marre masat edhe keta te fundit per sigurimin dhe ruajtjen e objekteve te kerkuara e te kontraktuara per kete.

## KREU VI . DISPOZITA TE PERGJITHSHME

**Neni 16**

Shoqeria "A-2000"sh.p.k e fillon aktivitetin e saj pasi te jete rregjistruar si person juridik ne gjykaten e rrethit Tirane, pasi te kete marre mirratimin nga organet e rendit te rrethit e te jete pajisur me licencen, lejen perkatese sic eshte parashikuar edhe ne ligjin nr.8770 dt.19.04.2001 dhe Udhezimit te M.R.P nr.1487 dt.21.06.2001 "Per procedurat e dhenies dhe heqjes se licencave dhe lejeve per shoqerite e ruajtjes dhe sigurise fizike".

**Neni 17**

Shoqeria "A-2000"sh.p.k e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me dispozitat e ketij statuti , ligjit nr.8770 dt.19.04.2001 dhe Udhezimeve re M.R.P siperpermendur si dhe ne kontratat qe jane lidhur per permbushjen e qellimeve te permendura ne Nenin 3 e 11 te ketij statuti. Ajo e bazon aktivitetin e saj ne te gjitha aktet ligjore e nenligjore qe lidhen me te dhe qe jane aktualisht ne fuqi.

**Neni 18**

Ky akt krijimi dhe statut hartohet ne tre kopje origjinale njera prej te cilave depozitohet ne Gjykaten e Rrethit Tirane, njera organit te rendit qe jep miratimin si dhe e treta mbahet nga administratori I vetem dhe I bashkelidhet dokumentacionit baze te shoqerise.

**ADMINISTRATORI I VETEM**

**KRENAR AGUSHI**







**K E R K U E S:** KRENAR AGUSHI,i biri i Vizhdanit,lindur me 10.08.1968,banues ne Tirane,Rr." Hamit Shijaku",Nr.3,me zotesi te plote juridike per te vepruar,me pasaporte Nr.0872808.

**O B J E K T I:** Kerkohet regjistrimi si person juridik i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A - 2000", Sh.pk,me baze ligjore,ligji 7368,date 19.11. 1992 dhe Nr.7667,date 28.12.1993.

## G J Y K A T E S  S E  R R E T H I T

## T I R A N E

Une kerkuesi KRENAR AGUSHI,ortak i vetem kam themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "A - 2000",Sh.p.k,me kapital themeltar 100.000 leke,me kohezgjatje mbi 10 vjet,me administrator KRENAR AGUSHI,me seli ne Tirane,Rr."Hamit Shijaku", Nr.3,dhe objekt te veprimtarise:

Sherbimi i Rojeve Civile te Armatosura,per ruajtjen e objekteve te ndryshme sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj shoqerie dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve te tyre dhe trensportimin e vlerave monetare ,duke mos perjashtuar mundesine e ruajtjes dhe te personave fizike,sipas kerkesave te paraqitura prej tyre gjithmone sipas kontrates qe do te lidhet per kete qellim midis ketyre personave dhe Shoqerise ne fjale, per Sherbimin e Rojeve Civile te Armatosura.

K E R K U E S I

/ KRENAR AGUSHI /

Tirane,me 10.12.1999

NR. 2 REP.

# PROCES-VERBAL

/Mbi depozitimin e kapitalit themeltar/

Ne Tirane,sot me date 10.12.1999 (Nentedhjetenente),para meje Ilir Qejvani,noter ne Rr."M.Shyri",u paraqit personalisht z.KRENAR AGUSHI, me pasaporte Nr.0872808,me banim ne Tirane,Rr."H.Shijaku",Nr.3,i cili beri depozitimin e kapitalit themeltar per krijimin e shoqerise "A - 2000",sh.p.k,me seli ne Tirane,ne vleren 100.000(Njeqintemije) leke.

Ky depozitim eshte si garanci per themelimin e shoqerise,bazuar ne ligjin 7638,date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare".

Ky proces verbal perpilohet me vullnetin e lire e te plote te z.Krenar Agushi,ortak i vetem i kesaj shoqerie,dhe pasi nenshkruhet lirisht prej tij para meje,une noteri e vertetoj sipas ligjit.

| DEPOZITUESI | NOTERI |
|---|---|
| Krenar Agushi | Ilir Qejvani |

REPUBLIKA E SHQIPERISE ILIR QEJVANI NOTER TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE TAKSE 100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "A – 2000" SH.P.K
TIRANË

# VENDIM
# I
# ORTAKUT TE VETEM

**Nr. 2, datë 07.03.2005**

Sot në datën 07.03.2005, unë Krenar Agushi me cilesinë e ortakut të vetëm dhe zotërues i të gjithe kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "A-2000" sh.p.k., rregjistruar si person juridik me vendimin nr.22447, datë15.12.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane,

Në bazë të ligjit nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike"

**VENDOSA**

1. Rritjen e kapitalit fillestar të shoqërisë nga 4.000.000 leke në **13.570.400 lekë.**

2. Emerimin si drejtues teknik me përvojë pune mbi 10 vjet z. Bardhosh Breshanaj.

3. Në bazë të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar" dhe formalitetet që duhen kryer në të kërkoj depozitimin në Regjistrin Tregtar të këtij vendimi.

**ORTAKU I VETEM DHE ADMINISTRATOR**

**KRENAR AGUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 819

## *VERTETIM*

Vertetoj se sot me date 11.03.2005 para meje noteres u paraqit Krenar Agushi per identitetin e te cilit pasi u sigurova, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper vendimi i ortakut te vetem eshte bere me vullnetin e tij te lire e te plote dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTER AFRODITA JEBERO

22447/2 S A

# KËRKESË

**KËRKUES : KRENAR AGUSHI** , i biri i Vizhdanit, lindur me 1968, banues në Tiranë, me pasaportë nr.0872808.

**OBJEKTI :** Depozitimi pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar të Vendimit nr.2, datë 07.03.2005 të ortakut të vetëm të shoqërisë "A – 2000"sh.p.k.

**BAZA LIGJORE :** Ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar".

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**TIRANE**

Une kërkuesi me cilesinë e administratorit dhe ortakut të vetëm tëshoqerisë "A-2000" sh.p.k., ju paraqes kërkesën për depozitim pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar të Vendimit nr.2, datë 07.03.2005 të ortakut të vetëm të saj, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 22447, datë 15.12.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin kam vendosur :

1. Rritjen e kapitalit fillestar të shoqërisë nga 4.000.000 lekë në 13.570.400 lekë.
2. Në bazë të ligjit nr.8770, datë 19.04.2001 neni 13 pika 2 është emëruar drejtues teknik z. Bardhosh Breshanaj.
3. Të pasqyrohen këto ndryshime në Regjistrin Tregtar.
4.

Në bazë të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar" dhe formalitetet që duhen kryer në të kërkoj depozitimin në Regjistrin Tregtar të këtij vendimi si dhe të bëhen ndryshimet përkatëse në aktin e themelimit dhe statutin e shoqerisë.

**ADMINISTRATORI**

**KRENAR AGUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 818

<u>*V E R T E T I M*</u>

Vertetoj se sot me date 11.03.2005 para meje noteres u paraqit Krenar Agushi per identitetin e te cilit pasi u sigurova, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i cili deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte bere me vullnetin e tij te lire e te plote dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTER AFRODITA GEGA

22447/1

3 A Sepe
06.07.2001

03.07.01

# KERKESE

**K E R K U E S : KRENAR AGUSHI ,** I biri I Vizhdanit, lindur me 1968, banues ne Tirane, me pasaporte nr.0872808.

**O B J E K T I :** Depozitimi prane Zyres se rregjistrit tregtar te vendimit nr.1 te ortakut te vetem te shoqerise "A – 2000"sh.p.k.

**BAZA LIGJORE :** Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregatr".

**GJYKATES SE RRETHIT**

**T I R A N E**

Une kerkuesi me cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise "A-2000"sh.p.k. ju paraqes kerkesen per depozitim prane Zyres se rregjistrit tregtar te vendimit nr.1 te ortakut te vetem te saj, e rregjistruar si person juridik me vendimin nr. 22447 date 15.12.1999 te Gjykates Shkalles se Pare Tirane, me te cilin kam vendosur :

1. Pakesimin e objektit te veprimtarise te shoqerise duke lene si objekt te saj vetem:

   "Sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike ose juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizike shtetas shqiptare ose te huaj"

2. Rritja e kapitalit fillestar te shoqerise nga 100.000 ne 4.000.000 leke.

3. Ne baze te ligjit nr.8770 date 19.04.2001 neni 13 pika 2 eshte emeruar drejtues teknik z.Shkelqim Lazaj.

4. Te pasqyrohen keto ndryshime ne rregjistrin tregtar.

Ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te kerkoj depozitimin ne rregjistrin tregtar te ketij vendimi si dhe te behen ndryshimet perkatese ne aktin e tthemelimit dhe statutin e shoqerise.

**ADMINISTRATORI**

**KRENAR AGUSHI**

**VENDIM NR.1 DT.20.07.2001**
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE " A – 2000 "sh.p.k**

Une ortaku i vetem I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "A-2000"sh.p.k, rregjistruar si person juridik me vendimin nr.22447 dt.15.12.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane, meqenese deshiroj qe aktivitetin privat ta ushtroj vetem ne fushen e

"Sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike ose juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise

Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizike shtetas shqiptare ose te huaj "

me cilesine e ortakut te vetem te saj dhe zoterues i te gjithe kapitalit te kesaj shoqerie me vendimin nr.1 date 20.07.2001, bazuar ne aktin e themelimit, statutin e shoqerise dhe ne ligjin 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar"

**VENDOSA**

1. Pakesimin e objektit te veprimtarise se shoqerise dhe lenien si objekt te saj : "Sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike ose juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e republikes se Shqiperise dhe sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizike shtetas shqiptare ose te huaj"

Ne baze te ligjit nr.8770 date 19.04.2001 "Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike

2. Rritjen e kapitalit fillestar te shoqerise nga 100.000 ne 4.000.000 leke.
3. Emerimi i drejtuesit teknik me pervoje pune mbi 10 vjet z.Shkelqim Lazaj.
4. Ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te kerkoj depozitimin ne rregjistrin tregtar te ketij vndimi.

**ORTAKU I VETEM DHE ADMINISTRATOR**

**KRENAR AGUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR.__6.__REP

# V E R T E T I M

Me te cilin vertetoj se **z.Krenar Agushi** i biri i Vizhdanit, I datelindjes 1968, lindur dhe banues ne Tirane, Rr."Hamid Shijaku" nr.3 sot me dt.20.07.2001, ka depozituar prane kesaj zyre shumen 5 000 000(pese milion) leke , per efekt te zmadhimit te kapitalit te shoqerise **"A–2000"** sh.p.k, deri ne perfundimin e procedures se rregjistrimit ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

**N O T E R E**
**XHEVAHIRE BRAHAJ**